



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 76, datë 23.05.2019

PËR
ANULIMIN PJESËRISHT TË VENDIMIT NR.74, DATË 20.05.2019, TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 109, shkronja “b” dhe 113 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 97, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, kryesisht, mbasi konstatoi që paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, e Vendimit nr.74, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative të përcaktuar në Vendimin nr.30, datë 14.02.2019, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”,

VENDOSI:

1. Anulimin e paragrafit I, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, të Vendimit nr.74, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.
2. Heqjen nga publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të paragrafit I, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, të Vendimit nr.74, date 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR